

VENDIM
Nr. 381, datë 10.7.2025

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 384, DATË 29.6.2023,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘REHABILITIMI I RRUGËS SË ISH-
REPARTIT USHTARAK PËR NË AEROPORTIN E RINASIT’”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 384, datë 29.6.2023, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) në pikën 3, fjalët “... vlera e përgjithshme prej 477 120 (katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzet) lekësh.” zëvendësohen me “...vlera e përgjithshme prej 1 482 432 (një milion e katërqind e tetëdhjetë e dy mijë e katërqind e tridhjetë e dy) lekësh.”;

b) pika 4, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 1 482 432 (një milion e katërqind e tetëdhjetë e dy e mijë e katërqind e tridhjetë e dy) lekësh përballohet, si më poshtë vijon:

a) vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 477 120 (katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzet) lekësh përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar;

b) vlera shtesë prej 1 005 312 (një milion e pesë mijë e treqind e dymbëdhjetë) lekësh përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.”;

c) kudo në përmbajtje të vendimit, fjalët “pronarit të pasurisë së paluajtshme”, “pronari i pasurisë së paluajtshme” dhe “pronarit të shpronësuar” zëvendësohen përkatësisht me “pronarëve të pasurisë së paluajtshme”, “pronarët e pasurive të paluajtshme”, “pronarëve të shpronësuar”;

ç) tabelës bashkëlidhur vendimit nr. 384, datë 29.6.2023, të Këshillit të Ministrave, i shtohet tabela, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Bashkëpronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën shtesë që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

3. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e bashkëpronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

4. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

5. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kamzë–Vorë, Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURIA E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE E TË CILËVE SHPRONËSOHET, PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT “REHABILITIMI I RRUGËS SË ISH-REPARTIT USHTARAK PËR NË AEROPORTIN E RINASIT”

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastral e	Numri pasuris ë	Sip. Total e m ²	Lloji pasuris ë	TOKE ARË			VLERA TOTALE (LEKË)	ADRESA	SHËNIME
								Sip. e shpronësuar	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera lekë			
2	Balfin Construction,	Blendi Hektor	Fevzi	1669	241/6	89177.2	Arë	2244	448	1005312	1,005,312.00	Tiranë (Fushë-Prezë)	
	Vlera totale							2244	448	1005312	1,005,312.00		